



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 507 prot.

Himarë, më 01.02.2022

VENDIM

Nr. 3, datë 28.01 2022

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË HIMARË, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJEN E Z.MIFTAR DAUTAJ DHE OBJEKTI VLASHI PETROL BANESAT E TË CILIËVE JANË DËMTUAR NGA ZJARRI.

Këshilli i Bashkiak Himarë, në mbledhjen e datës __. __.2022, me propozimin e kryetarit të bashkisë, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 54 shkronja “dh”, Ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, V.K.M. nr 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr.263, datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore.” **Keshilli i Bashkisë Himarë në mbledhjen e tij dt;28.01.2022 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Mirembajtjes,Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Social ,Drejtoria Juridike ,ne perfundim ...**

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Himarë për ndihmën e menjëhershme financiare familjes së Z. Miftar Dautaj, në vlerën 50% të vlerës së vlerësimit në lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Himarë, për familjen e Z. Miftar Dautaj në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 646,830 (gjashtëqind e dyzetë e gjashtë mijë e tetëqind e tridhjetë) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 205,142 (dyqind e pesë mijë enjë qind e dyzetë e

- dy) lekë, sipas preventivivave të komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Himarë, për familjen e Z. Miftar Dautaj.
3. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Himarë për ndihmën e menjëhershme financiare familjes të Vlashi Petrol, në vlerën 50% të vlerës së vlerësimit në lekë, për dëmtimin e banesës së tij nga zjarri.
 4. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Himarë, për Vlashi petrol në vlerën e dëmit nga ana ndërtimore 177,448.00 (njëqind e shtatë e shtatë mijë e katër qind e dyzet e tetë) lekë, dhe në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake në vlerën prej 450,000.00 (katërqind e peziet mijë) lekë, sipas preventivivave të komisionit të vlerësimit të dëmeve pranë Bashkisë Himarë, për familjen Vlashi petrol.
 5. Burimi i financimit të jetë fond i emergjencave civile parashikuar në programin “Emergjencat civile” në buxhetin e Bashkisë Himarë për vitin 2022 të miratuar me VKB nr 62, datë 21.12. 2021.
 6. Ngarkohet administrate e Bashkisë Himarë për likuidimin e shumës prej 50% të vlerës preventive nga komisioni i vlerësimit për z.Miftar Dautaj.
 7. Ngarkohet administrate e Bashkisë Himarë për likuidimin e shumës prej 50% të vlerës preventive nga komisioni i vlerësimit për Vlashi Petrol.
 8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Vota pro 12 (dymbëdhjete)

Vota kundra 0 (zero)

Vota abstenim 0 (zero)

SEKRETARI

Elena Memushaj



KRYETARI

Dhimiter Kapaj